

15/09/2020

AKT THEMELEUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE "B Property Management" Sh.P.K

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksinomin dhe mbrojtjen e prones private nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit " dhe te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008,, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

- **Alban Babamusta**, i datëlindjes 01/02/1991, shtetas Shqiptar,banues në Durres, identiteti i të cilit verifikohet me kartën e identitetit me nr. personal J10201072R

Krijoi shoqerine tregtare private me pergjegjesi te kufizuar "B Property Management"" dhe me aktin themelues te saj si vijon:

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "B Property Management"" sh.p.k dhe me emer tregtar "B Property"" Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia Qëndrore e shoqërisë është në adresën: DURRES Lagjja nr.3, Sheshi Liria, kati 6, Qendra e Biznesit EGT, Durres

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e:

Menaxhimi i pasurise se paluajtshme.

Menaxhim te Projekteve te ndryshme te te gjitha fushave hartim dhe zbatimin e projekteve ne fushen e investimeve, të industrise, turizmit, infrastruktures, telekomunikacionit, energjitikes, mjedisit, bujqesise, shendetesise, arsimit, sportit, arkologjise, hidroteknikes, ndertimit hidrocentrale dhe Hartimi i studimeve, projekteve, zbatimi i tyre, ne fushen e ndertimeve civile, industriale, turistike, telekomunikacionit, Aeroportit, energjitikes, mjedisit, bujqesise, shendetesise, arsimit, kultures, sportit, arkeologjise, ndertimeve civile, ndertimi, rruges,

15/09/2020

kanalesh, ura, ujesjelles, kanalizimeve, impjante vaditese, vepra arti te cdo lloji, hidrocentrale dhe termocentrale, rikonstruksioni i godinave dhe objekteve te cdo lloji te rendesise ekonomike e sociale.

Sherbime konsulence Inxhinierikem, Juridike, Financiare profesionale si per Projektim inxhinierik dhe administrim, Planifikim projekti dhe administrim, Administrim te riskut ne ndertim, Administrim te programit te ndertimit, Administrim te fazes se ndertimit, Administrim te kostos se ndertimit, Administrim i i pretendimeve dhe ankesave, Mbrojtje ligjore ndertimore, Sipermarrije ndertimore dhe zbatim projektesh, Sherbime specifike ndertimore si supervizion ndertimore, hartim dokumentacion tenderi, formim dhe hartim procedurash te brendshme per funksionimin e kompanive ndertimore.

Ofrimin e sherbimeve per administratoret e bashkepronesise dhe pronaret e pasurive te paluajtshme, ose direkt ose nepermjet kontratave te menaxhimit te dhene paleve te treta;

Sherbim ne administrimin e bashkepronesise ne ndertesat e banimit, objekteve civile , etj.

Aktivite te lavanderise .

Pastrime te objekteve te ndryshme shtetore dhe private, rruge , ndertesa, objekte te ndryshme , etj.

Administrimi i hapësirave te parkimit dhe strukturave te sherbimit per parkimin e automjeteve.

Mirembajtjen dhe servis te ashensoreve, shkalleve elektrike dhe paisjeve ndihmese ne levizjen e njerezve, mjeteve dhe mallrave.

Instalim dhe mirembajtje te sistemeve te vezhgimit dhe kamerave te sigurise.


Riparimit, mirembajtjes e instalimit te istemeve te kondicionimit. transportimit te sistemeve elektrike - hiraulike, sistem ngrohje ftohje, sistem kondicionimi. instalimit, mirembajtjes, riparimit te sistemit kunder zjarrit. projektimit dhe zbatimit, te projekteve per sistemet elektrike, hidraulike, system ngrohje -ftohje, sistem kondicionimi, sistem anti zjarr.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se sa shoqeria do te siguroje mjetet e nevojshme te transportit, do te hape objetke e njesi sherbimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike e juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5



15/09/2020

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar I shoqerise private "**B Property Management**" sh.p.k do te jete 100.000 leke dhe do te perbehet nga 1 kuote e ortakeve themelues te shoqerise si vijon:

- **Alban Babamusta**, i datëlindjes 01/02/1991, shtetas Shqiptar,banues në Durres, identiteti i të cilit verifikohet me kartën e identitetit me nr. personal J10201072R me pjesemarrje 1 kuote ne perqindje 100% ne kontribut ne vlere monetare 100.000 leke.

Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve. Kuotat e pjesemarrsesve ne kapital jane te gjitha te emeruara dhe te pandashme. Kapitali eshte teresisht I shlyeshem dhe I nenshkrueshem.

NENI 7

Ortaket duhet te bejne perpjekje per rritje e potencialit ekonomik te shoqerise, te ruajne sekretin e saj dhe te mos demtojne interest e personave te tjere dhe te shoqerise.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqeria do te drejtohet nga administrator I saj, caktuar nga ortakët themelues te shoqerise, z. Alban Babamusta , I cili eshte edhe perfaqesuesi ligjor I saj per nje afat 5 vjecar.

NENI 9

Te ardhurat neto te shqiperise I takojne ortakeve themelues te shoqerise ne proporcion me kuotate tyre ne kapitalin fillestar.

NENI 10

Ortakët themelues kane te drejte te emerojne dhe administrator te tjere te vlerave material te shoqerise. Ata kane te drejte te caktojne financier, likuidator per problemet e shoqerise, si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te shoqerise.

NENI 11



15/09/2020

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne gjykatën e shkalles se pare Durres.

Neni 12

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme, me tekstin per rethin e saj.

NENI 13

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statute dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008, "Mbi krijimin e shoqerive tregtare: NENI 14

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas marrjes se lejes nga organet kompetente. NENI 15

Akti I themelimit, u perpilua ne disa kopje per t;iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregtare private "**B Property Management**" sh.p.k.

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"B Property Management" sh.p.k.

Alban Babamusta

